

Integrimi dhe Ri-Integrimi në shoqëri i të miturve në risk / konflikt me ligjin”

Integration and Re-integration in society
of minors in risk / conflict with law



Rrjeti për Zhvillim Komunitar
“Sot për të Ardhmen”
“Today for the Future”
Community Development Network

unicef 

Integrimi dhe Ri-Integrimi në shoqëri i të miturve në risk / konflikt me ligjin

Integration and Re-integration in society
of minors in risk / conflict with law



Rrjeti për Zhvillim Komunitar
"Sot për të Ardhmen"
"Today for the Future"
Community Development Network



Përmbajtja / Table of Contents

MIRËNJOHJE ACKNOWLEDGMENTS.....	2
DY FJALË FOREWORD.....	3
METODOLOGJIA E HULUMTIMIT RESEARCH METHODOLOGY.....	4
PREZANTIM I PROJEKTIT PROJECT OVERVIEW.....	7
Metodologjia e Ndërhyrjes Intervention methodology.....	10
REZULTATET RESULTS	12
a.Pjesëmarrja dhe gjetje a.Participation and findings.....	14
b.Tipologjia e rasteve, kategorizimi i mjedisit dhe shkaqeve influencuese b.Typology of cases, classification of environment and influencing causes.....	17
c.Perceptimi i të miturve mbi faktorët/shkaqet që nxisin sjelljen deviante c.Minors' perception about the factors/causes that lead deviant behavior.....	18
d.Perceptimi i prindërve mbi faktorët/shkaqet që nxisin sjelljen deviante d.Parents' perception of the factors/causes that lead to deviant behavior.....	19
e.Krahasimi i perceptimeve të mitur/prindër e.Comparing perceptions of minors toward those of the parents.....	20
DISA REFLEKTIVE SOME REFLECTIONS.....	22
Përmbledhje e gjetjeve Summary of findings.....	24
Rezultatet e sesioneve të trajnimeve Results of training sessions.....	25
Puna më tej me raste të veçanta Further work with specific cases.....	25
MESAZHE NGA TË MITURIT NË RISK/KONFLIKT ME LIGJIN DHE PRINDËRIT E TYRE MESSAGES FROM THE MINORS AT RISK/IN CONFLICT WITH THE LAW, AND THEIR PARENTS.....	27

Ky botim u mundësua nga UNICEF Shqipëri në kuadrin e projektit “Integrimi dhe Ri-Integrimi i të miturve në shoqëri nëpërmjet normave, vlerave dhe të jetuarit sipas ligjit”, zbatuar nga Qendra për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen”.

Përmbajtja e botimit është përgjegjësi e rrjetit “Sot për të Ardhmen” dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht pikëpamjet e UNICEF Shqipëri.

Botimi paraqet metodologjinë e ndërhyrjes, të dhënat sasiore dhe cilësore të arritura gjatë zbatimit të projektit, si dhe mesazhe të të miturve dhe prindërve si pjesë të projektit.

Mesazhet e të miturve dhe prindërve janë zhveshur nga çdo lloj e dhëne që cënon konfidencialitetin e të dhënave personale dhe të drejtat e fëmijëve.

Fotot e publikuara në këtë botim janë marrë gjatë veprimtarisë së projektit me miratimin e prindërve dhe të miturve. Në kuadër të ruajtjes së të dhënave personale, konfidencialitetit dhe në mbrojtje të të drejtave të të miturve, pjesë të fotove janë të sfumuara, si dhe fotot e vendosura pranë mesazheve, nuk janë të lidhura me përmbajtjen, situatat apo me të miturit dhe prindërit e rastit referent.

Udhëheqës Shkencor: Prof.Doc. Ylljet Aliçka
Udhëheqës i botimit: MA. Fabiola Laço Egro
Perkthyes: Evis Cerga
Dizenjimi dhe faqosja: Klevis Dollonja

Publikuar nga: Rrjeti “Sot për të Ardhmen”, Shqipëri

E Drejta e Autorit:

© 2016 UNICEF Shqipëri, Rrjeti “Sot për të Ardhmen”, Shqipëri

ISBN: 978-9928-4302-2-9

This publication was made possible by UNICEF Albania in the frame of “Integration and Re-integration of minors in society through norms, values and law-abiding lifestyle” Project, implemented by Community Development Center “Today for the Future”.

The views expressed in this publication are responsibility of “Today for the Future” Network and do not necessary reflect those of UNICEF Albania.

The publication presents the intervention methodology, quantitative and qualitative figures of project implementation and messages of minors and their parents involved in the project.

Messages of minors and parents are devoid of personal identifiable data to preserve confidentiality and children’s rights.

Enclosed photos are taken during the project activities with the consent of parents and minors. To protect personal data, confidentiality and children’s rights, part of photos are blurred. Photos placed next to messages are not linked to them and do not illustrate content, situation or minors and parents of the referent case.

Scientific Leader: Prof.Dr. Ylljet Aliçka
Publication Leader: MA. Fabiola Laço Egro
Translated by: Evis Cerga
Design and layout: Klevis Dollonja

Published by: “Today for the Future” Network, Albania

Copyright:

© 2016 UNICEF Albania, “Today for the Future” Network, Albania

ISBN: 978-9928-4302-2-9

Cover Photos:

Front cover photo: *photo taken during project activity, where the young volunteer is expressing his commitment to support minors in conflict with law. © “Today for the Future,” with consent of young volunteer*

Back cover photo: *photo taken during project activity, where father and minor are re-building their relationship through their work to the benefit of community. © “Today for the Future” with consent of father and minor.*

Kopertina:

Foto e parë e kopertinës: *foto e marrë gjatë veprimtarisë së projektit, ku një i ri vullnetar shpreh angazhimin e tij për të mbështetur të miturit në konflikt me ligjin. © “Sot për të Ardhmen,” me miratimin e vullnetarit të ri.*

Foto e dytë e kopertinës: *foto e marrë gjatë veprimtarisë së projektit, ku atë e bir rindërtojnë marrëdhëniet midis tyre, nëpërmjet punës në interes të komunitetit. © “Sot për të Ardhmen,” me miratimin e babait dhe të miturit.*

Mirënjohje / Acknowledgments

Rrjeti “Sot për të Ardhmen” shpreh mirënjohjen ndaj UNICEF Shqipëri për mbështetjen në punën me të miturit në risk dhe në konflikt me ligjin, me prindërit e tyre dhe për ndihmesën e vazhdueshme të dhënë gjatë kohës.

Çmujmë mbështetjen dhe bashkëpunimin e institucioneve në Tiranë, Durrës dhe Pukë si Gjykatat, Zyrat e Shërbimit të Provës, Prokuroria, Policia, Drejtoritë Arsimore Rajonale, shkollat 9 vjeçare e të mesme, si dhe shkollat e arsimit profesional.

Falenderojmë prindërit dhe mësuesit për pjesëmarrjen dhe kontributin e tyre në misionin e lartë të edukimit dhe të mirërritjes së fëmijëve dhe të rinjve në risk /konflikt me ligjin, si dhe në sigurimin e integritetit të tyre social në përputhje me vlerat dhe normat.

Falenderimet më të veçanta janë për fëmijët dhe të rinjtë që pavarësisht situatave personale, hodhën hapat e parë në ndërtimin dhe rindërtimin e ardhmes së tyre, me mbështetjen e një grupi të tërë nga Rrjeti “Sot për të Ardhmen”: punonjës socialë, psikologë, juristë, mentorë, si dhe me përfshirjen e prindërve të tyre e ekspertëve të institucioneve të drejtësisë e komunitetit. Tashmë procesi i mëtejshëm ka një bazë të ngritur sigurie dhe vetbesimi në integrimin dhe ri-integrimin e tyre në një shoqëri të shëndetshme dhe bazuar në vlera dhe norma.

“Today for the Future” Network would like to express its acknowledgments to UNICEF, Albania for its support in the work with minors at risk and children in conflict with the law, their parents and the continuous support at all times.

We appreciate the support and cooperation of institutions in Tirana, Durrës and Puka, such as: courts, Probation offices, the police, Regional Education Departments, 9th grade and high schools, and Vocational Education Training schools (VET).

We would like to express our thanks to the parents and teachers for their participation and contribution in the supreme mission of education and well-being of children and youth at risk and or conflict with the law, and for ensuring their social integration in line with the prevailing values and norms.

Most special thanks go for the children and youth who despite their personal situations, took their first steps towards shaping and re-building their future, with the support of the whole team of the network of staff, social workers, legal advisors, mentors of “Sot për të Ardhmen” network, and the involvement of parents and experts of institutions of justice and the community. Now, the process that is in place has provided for security and self-confidence in their integration dhe re-integration in a healthy society, and based on sound norms and values.



Dy fjalë / Foreword

Kur e nisëm këtë projekt, e dinim që nuk do të ishte e lehtë të mblidhnim bashkë fëmijët në risk dhe në konflikt me ligjin me prindërit, institucionet e drejtësisë, shkollat e komunitetin.

Kur pak nga pak lulëzojnë rezultatet e para, çdo formë lodhjeje dhe tensioni transformohet në energji për të punuar më tej. Është kënaqësi kur sheh një të mitur të inatosur me veten e shoqërinë që tashmë buzëqesh dhe është miqësor; një fëmijë të ndrydhur që tashmë shprehet lirshëm me moshatarët e tij; është kënaqësi kur sheh se si prindi dhe fëmija që nuk komunikojnë me njëri-tjetrit, e bëjnë rugën bashkë si shokë; ndjehesh plot shpresë kur i sheh këta fëmijë dhe të rinj që janë gjithë ide, që gjejnë kuptimin e jetës, që ravigëzojnë rugën e së ardhmes së tyre dhe e bëjnë më kuptimplotë jetesën në komunitet me nisma gjithëpërfshirëse; ndjehesh e motivuar edhe kur të gjitha institucionet dakortësohen për të bërë më të mirën për të miturit në vështirësi, në risk apo në konflikt me ligjin, për t'i integruar në shoqëri e për t'i dhënë shanse të barabarta me bashkëmoshtarët.

Të gjithë ne punojmë për të siguruar një të ardhme më të mirë fëmijëve, për t'u lënë një trashëgimi të vlefshme në vlera e qytetari. E në këtë mision të lartë, një angazhim edhe më i madh nevojitet në trajtimin e atyre fëmijëve dhe të rinjve që për një arsye apo tjetrën, gjenden në udhëkryqin e rritjes së tyre, midis dilemave të vlerave dhe antivlerave, midis paqes dhe konfliktit.

Misioni ynë është t'u japim dorën për të rrugëtuar shëndetshëm dhe detyra jonë t'u japim çdo ndihmë për të kapërcyer vështirësitë ku mund të ngërthehen dhe t'i ri-integrojmë. Në një shoqëri që evoluohet me shpejtësi, ku risitë por edhe risqet shtohen dhe zhvillohen, shpejtësia dhe saktësia e ndërhyrjeve parandaluese dhe restauruese duhet të prevalojnë, që të mundësojmë perspektivën pozitive në rritjen e çdo të mituri.

Fabiola Laço – Egro

Drejtoreshë Ekzekutive / Executive Director

OZHK Sot për të Ardhmen / “Today for the Future”

When we started this project, we knew it would not be easy to bring together children at risk, and children in conflict with the law, with the parents, institutions of justice, schools and the community.

When slowly but steadily, we are able to reap the first results, any form of tension or signs of tiredness are transformed into more energy for further work. It is a pleasure when you see a what-used-to be angry child with himself and the society smiling now and being friendly; a timid frustrated child who can now express himself freely with his peers; it is a pleasure when you see once estranged parents and children communicate with each-other and travel the path together as friends; you feel hopeful when you see these children and youth full of ideas, trying to finding meaning to their lives, and shaping their futures and making life in the community more meaningful through inclusive initiatives; you feel motivated when all institutions agree to do their best for minors at risk, children in conflict, to ensure their integration in society and to give them equal opportunities with their peers.

All of us work towards ensuring a better future for the children, to live them a valuable legacy and civic values. In the spirit of this important mission, it is important to ensure bigger commitment for addressing the needs of these children and youth who for one reason or other are at the crossroads, torn between dilemmas of values and anti-values, between peace and conflict.

Our mission is to lend a hand to these children and youth in what is supposed to be a healthy way ahead, and give them every bit of assistance to overcome any difficulty where they might be entangled and ensure their re-integration. In a rapidly developing society, with added novelties, as well as risks, the speed and accuracy of preventive and restorative interventions should prevail, in order to ensure a positive approach in the growth of every child.



Metodologjia e Hulumtimit Research methodology

Metodologjia e Hulumtimit

Mbështetur mbi natyrën e kërkimit të projektit u zbatua metodologjia e përzier cilësore/sasiore (cilësore – përzgjedhja dhe puna me minorët në risk/konflikt me ligjin dhe prindërit e tyre), (sasiore – nxjerrja dhe përpunimi i të dhënave sasiore që mbështesin apo shoqërojnë metodologjinë e hulumtimit)

Ndërsa si instrumente kërkimore krahas të tjerave, u përdor komunikimi, sipas parimit Goffman¹ *“Mënyrat e komunikimit me të tjerët nxjerrin nga thellësia e ndërgjegjes, mendime dhe ndjenja të fshehura, duke tradhtuar kështu, përpjekjet e vullnetshme për të maskuar anë të veçanta të personalitetit tonë.”*

Gjatë procesit të komunikimit u patën parasysh këto kriterë bazë:

Me cilin komunikon (veçoritë e secilit subjekt (imitur, prind etj), si rast më vete); Përse do komunikoj (me çfarë motivi, qëllimi, përfundimi); Për çfarë do komunikoj (konteksti ose brendia e komunikimit); Metoda e komunikimit (përshëndetje, rrëfim, bisedë, replikë); Sjellja gjatë komunikimit (etika, stili, takti); Ku do komunikoj (mjedisi, klasë, zyrë, sallë, rrugë, shtëpi); Ecuria e komunikimit (normale, e qetë, e tensionuar, me rrjedha të qeta apo tensione emocionale) etj.,

Gjatë seancave komunikuese, mentorët, trajnerët dhe psikologët krijuan kushte për zbulimin dhe formimin e individualitetit të të miturve në risk/konflikt me ligjin, me synimin e ringjalljes së kompetencës morale qytetare duke përfshirë prindërit në këtë proces mbështetës.

Përzgjedhja e kësaj ecurie psikologjike u mbështet mbi synimin natyral të çdo të mituri (jo vetëm të atyre me sjellje konform standarteve shoqërore dhe ligjore, por edhe atyre në risk/konflikt me ligjin) për vetëveprim, vetëpërmirësim për gjendjen e ekuilibruar brenda vehtes dhe me botën që e rrethon. E njëjta përjasje në synimet natyrale vlen dhe për prindërit, pavarësisht nivelit arsimor, social dhe ekonomik.

Një prej elementëve të metodologjisë së përdorur është shmangia sa më shumë e tendencës për të komunikuar

1 Erving Goffman (1922-1982)

Research methodology

Based on the type of project research, the methodology used was that of quantitative/qualitative mixture (qualitative – selection and work with minors at risk/conflict with the law and their parents), (quantitative – collection and processing of quantitative data that support or accompany the research methodology).

Whereas in addition to others, one of the research methodologies used was that of communication, according to the principle of Goffman¹ *“Ways of communicating with others tend to take out from the depths of consciousness, hidden thoughts and feelings, thus betraying willing efforts to hide specific traits of our personality.”*

During the process of communication we took the following criteria into account:

Who is the person communicating with (specificities of each subject (is he/she a minor/parent etc.), as a separate case); What is the purpose of the communication (what is the purpose, motive, end); What will I be communicating about (the context or topic of communication), Means of communication (greeting, narration, conversation, rhetoric); Behavior during communication (ethics, style, tact); Where will I be communicating (environment, classroom, office, hall, street, at home); Progress of communication (normal, calm, tense, normal flow or emotionally tense) etc.,

During the communication sessions, mentors, trainers and psychologists created conditions for discovering and shaping the individuality of all minors at risk/children in conflict with the law, with the view of revival of the moral civic competence while involving the parents in this support process.

The selection of this psychological process was based on the natural goal of every minor (not just those whose behavior is in line with the social and legal standards, but also those at risk/conflict with the law) for self-action, self-improvement to ensure a balanced status inside oneself

1 Erving Goffman (1922-1982)

në nivelin e detyrës, duke i dhënë njëkohësisht përparësi dhe aspektit emocional, i cili për shkak të peshës dhe kohëzgjatjes së tij, është shumë i rëndësishëm për modulimet e qëndrimeve etike si të të miturve në risk/konflikt me ligjin ashtu dhe të këshilluesve të tij (prindër, mësues, institucione riedukimi etj).

Kjo dhe për faktin se emocionet janë më të lexueshme, të paktën për subjektet (të miturit, prindërit), të cilët nuk e kanë përvojën e përballimit të tyre, nuk i njohin teknikat e manipulimit, maskimit, pakësimit, nxitjes apo neutralizimit të emocioneve,

Jo rrallë aspekti emocional krijoi probleme, sidomos kur vetë të miturit dhe prindërit dështonin në njohjen e të vërtetave dhe fakteve reale të vetë komunikimit, si pasojë e vetbesimit ndaj qëndrimeve moskomunikuese, emocioneve apo ndjenjave të veta.

Si hap të parë ndoqëm rrugën e bindjes së të miturit në risk/konflikt me ligjin, që ai ta pranojë mendimin ndryshe dhe të paraqitur nga një tjetër (prind, mësues, psikolog, trajner, bashkëmoshatar etj), të cilin ai e kundërshtoi me mosbesim vetëm për faktin e thjeshtë se ja ka paraqitur një tjetër; duke u pasuar me hapat e tjerë të përfshirjes në proces të prindërve dhe më pas të mësuesve dhe institucioneve ligjore.

Thënë ndryshe përfaqëson jonë ishte më shumë bashkëpunuese në vend të rolit sundues, për të arritur një zgjidhje etike pa të humbur: pra si të të bësh bashkë: të miturit në risk/konflikt me ligjin – prindërit – institucionet referente² - mësuesit, të ecin krah për krah, duke krijuar klimën e besimit, duke përzier qëllimin e jetës së tyre me rrjedhën e përgjithshme.

Prof. Doc. Ylljet Aliçka
Udheheqës Shkencor / Scientific Leader

² Gjykatat, Zyrat e Shërbimit të Provës, Prokuroria, Policia, Drejtoritë Arsimore Rajonale, shkollat 9 vjeçare e të mesme, si dhe shkollat e arsimit profesional

and the world around each person. The same approach regarding natural goals applies to parents, irrespective of their education, social and economic status.

One of the elements of the methodology used is avoidance to the maximum possible of the inclination/tendency to communicate from duty approach, thus concomitantly giving priority to the emotional aspect, which due to its weight and duration is very important for shaping ethical attitudes/approaches both of minors at risk/conflict with the law and their counselors (parents, teachers, re-education institution etc.).

This is also due to the fact that emotions are more obvious, at least for subjects (such as minors, and parents) who do not have experience in living up to them, or are not aware of the manipulation, cover-up, reduction, enhancing or neutralization of emotions techniques.

It was not rare when emotions led to problems, in particular when the minors and the parents failed to see the truth and reality of communication per se, as a result of self-confidence towards non-communicative attitudes, emotions or own feelings.

As a first step, we tried to convince the minors at risk/children in conflict with law to accept a different opinion coming from someone else (no matter who that someone else was: a parent, teacher, psychologist, trainer, peer etc.), to which the minor is objecting to in distrust, simply because of the mere fact that someone else has presented it; followed by other steps, such as involving the parents in the process, and then the teachers and the legal institutions.

In other words, through our approach we were trying to be more cooperative and try to replace the domineering role, with the view of achieving an ethical win-win solution for all parties, in more other words bringing together: minors at risk/children in conflict with the law – their parents – reference institutions² -teachers, to walk together, while building a climate of trust, mixing their life goals with the general flow.

² Courts, Probation Offices, Prosecution Offices, Police, Regional Education Directorates, 9th grade schools, general and VET Schools



Prezantim i Projektit

Project Overview

Prezantim i Projektit

“Integrimi dhe Ri-integrimi i të miturve në shoqëri nëpërmjet normave, vlerave dhe të jetuarit sipas ligjit” është fokusi i ndërhyrjes së realizuar nga Rrjeti “Sot për të Ardhmen” përgjatë një periudhe 9 mujore 2015-2016, në Tiranë, Durrës dhe Pukë, me mbështetjen financiare dhe teknike të **UNICEF Shqipëri**.

Kjo ndërhyrje synon të kontribuojë në edukimin e të miturve dhe sidomos të atyre në konflikt me ligjin, për të vepruar dhe jetuar në përputhje me vlerat, normat dhe ligjet në fuqi, me qëllim sigurimin që brezi i ri të jetë pjesë aktive dhe model qytetar i një shoqërie shqiptare të civilizuar dhe të përgatitur për të qenë pjesë e Bashkimit Europian.

Kjo sipërmarrje vjen si nevojë për të adresuar problematikën në rritje të të miturve si në konflikt me ligjin, ashtu dhe si viktime të dhunës në familje dhe shoqëri. Gjithashtu vjen si domosdoshmëri për njohjen e kuadrit ligjor për të miturit vetë, prindërit apo grupi social ku bëjnë pjesë, dhe të strukturave dhe procedurave ligjore në rastet e trajtimit të çështjeve.

Për të kontribuar në këtë qëllim madhor, qeveria shqiptare në bashkëpunim me UNICEF punojnë me një sërë organizatash të shoqërisë civile, puna e të cilave komplementon panoramën e gjerë të ndërhyrjeve.

Konkretisht, “Sot për të Ardhmen” si rrjet lider për

Project Overview

“Integration and Re-integration of minors in society through norms, values and living on the side of the law” is the focus of the intervention carried out by the “Today for the Future” network throughout a period of 9 months, 2015-2016, in Tirana, Durrës and Puka, with the financial and technical support of **UNICEF, Albania**.

This intervention is aimed at contributing in the education of minors, and in particular children in conflict with the law, to act and live, in line with the values, norms and on the side of the law, with the view of making sure that the new generation should be active and role model citizens of a civilized Albanian society, prepared for becoming eventual part of the European Union.

This process is a response to the need of addressing increasing issues/challenges in relation to minors in conflict with the law, and children victims of domestic violence and society problems. In addition, this initiative is a response to the need of getting the minors, parents or any social group of their involvement with the legal framework, and the legal structures and procedures in the instances of addressing the cases.

To contribute to this big cause, the government of Albania, in cooperation with UNICEF are working together with a number of civil society organizations (CSOs), whose field of expertise complements the broad picture of other interventions.

mobilizimin e grupeve komunitare, kontribuon në këtë qëllim nëpërmjet fushës së ekspertizës së tij, duke punuar me familjen si bërthamë ku nisin vlerat dhe normat, si pikënisje shoqërore dhe si model shoqëruës për fëmijët gjatë rrugëtimit të tyre personal dhe shoqëror.

In practice, “Today for the Future” as a leading network in the area of mobilization of community groups is contributing to this end, through its field of expertise, placing the family at the center, and nucleus where all values and norms start taking shape, as a social starting point, and a model that will accompany the child in his/her personal and social path.



Metodologjia e Ndërhyrjes

Metodologjia e ndërhyrjes është zbatuar duke kombinuar disa modele trajtimi të rasteve. Janë kombinuar modelet e programeve në formë rrrathësh socialë: a) programe njëpalëshe: me grupet e veçanta të fëmijëve dhe të rinjve, dhe grupet e prindërve, b) programe dypalëshe: me grupe të përziera fëmijë-prindër, c) programe trepalëshe: me grupe të përziera fëmijë – prindër – institucione.

Metodologjia në këtë formë ka synuar rritjen e kapaciteteve të fëmijëve dhe prindërve në njohjen e kuadrit ligjor, mendimit kritik në analizën e situatave, dhe në veprime restauruese drejt integritimit apo integritimit social.

Në programet njëpalëshe, ndërhyrja është fokusuar në:

- Njohja e të miturve (në kontakt dhe në konflikt me ligjin) me kuadrin ligjor dhe edukimi ligjor dhe social i normave shoqërore.
- Njohja e prindërve (të të miturve në kontakt dhe në konflikt me ligjin) me kuadrin ligjor si dhe me aspektet e prindërimit, për të ndihmuar të miturit në parandalim/ri-integrim.

Në programet dypalëshe, ndërhyrja është fokusuar në:

- Përfshirja e të miturve (në kontakt dhe në konflikt me ligjin) dhe e prindërve në situata zgjidhjeje konflikti (win-win) për të shprehur perceptimin e tyre mbi konfliktin (faktorë, të dëmtuar/dëmtues, zgjidhje, post-konflikt) si dhe nivelin e përgjegjësive që merrnin përsipër.
- Nxitja e të miturve dhe e prindërve për të ushtruar dijen e marrë në situata konkrete (procesi i ndryshimit

Intervention methodology

The intervention methodology represents a combination of several models for case handling. It represents a combination of several models of programs in the shape of “social circles”: a) unilateral programs: with special groups of children and youth and parent groups, b) bilateral programs: mixed groups of children and parents, c) tripartite programs: mixed groups composed of children, parents and institutions.

This type of methodology aims at enhancing capacities of children and their parents in becoming familiar with the legal framework, critical thinking in analyzing different situations, and restorative acts aiming at their integration and social integration.

In Unilateral programs the intervention focuses on:

- Making minors (in contact and conflict with the law) familiar with the legal framework, providing them with legal and social education, and social norms.
- Acquainting parents (of minors in contact and in conflict with the law) with the legal and parenting aspects, in order to assist minors in the process of prevention/re-integration.

In bilateral programs, the intervention focuses on:

- Inclusion/involvement of minors (in contact and in conflict with the law) and their parents in win-win situations, and make them give their thoughts and express their perception of the conflict (factors, victims/perpetrators, solutions, post-conflict) and the level of responsibilities that they are taking over.

të sjelljes), si dhe për ta ndarë eksperiencën me njëritjetrin (në format dyshe prindër-fëmijë, në grup të kategorizuar prindër/ fëmijë, në grup miks prindër-fëmijë)

Në programet trepalëshe, ndërhyrja është fokusuar në:

- Ndërthurja e të gjithë aktorëve bashkë, si dhe njohja nga afër e institucioneve të ligjit.

Ndërtimi i sjelljes me bazë familjen, u aplikua në *disa prej rasteve të identifikuar*. Në këtë aspekt, metodologjia përfshiu:

- trajtimin individual të sjelljes (të mitur, prindër).
- Ndërtimin e marrëdhënieve dypalëshe prindër të mitur,
- Trajtimin në grup të sjelljes shoqërore (puna në komunitet)

- Urging minors and their parents to put their knowledge to real life situations (behavior change process), and to share their experiences with each-other (in bilateral groups: parents-children, in groups of children, groups of parents, in mixed groups of parents and children)

In tripartite programs, intervention focuses on:

- Bringing all actors together, and getting them to know from close the legal institutions.

Building family-based behavior was applied in several of the identified cases. In this aspect, the methodology included:

- Individual behavior treatment (minors, parents)
- Building bilateral relationships, between parents and minors
- Addressing in group the social behavior (community work)



Rezultatet Results

Rezultatet

Në këtë projekt u përfshinë rreth 190 fëmijë dhe të rinj në risk dhe në konflikt me ligjin, rreth 150 prindër, si dhe institucionet e referencës: Gjykatat, Zyrat e Shërbimit të Provës, Prokuroria, Policia, Drejtoritë Arsimore Rajonale, Shkollat 9 vjeçare, të mesme të përgjithshme e profesionale në Tiranë, Durrës, Pukë.

Mbështetur dhe në dokumentet bazë juridike si Konventa e OKB: "Manuali për mbrojtjen e fëmijëve", Kushtetuta e Shqipërisë, në të gjitha sesionet e trajtimit (programet njëpalëshe, dypalëshe dhe trepalëshe) patëm si objektiva për:

- *Të aftësuar të të miturit në risk për të qenë të pavarur, për të qenë të aftë të marrin vendimet e duhura për veten, në momentet e duhura dhe vendin e duhur,*
- *Aftësinë për të kuptuar veten dhe situatën*
- *Aftësinë për të minimizuar tensionet e të integruarit nga "të ndryshëm," drejt të qenurit vetja, drejt të qenit të pranuar në të drejtën e zgjedhjes së lirë, duke diktuar një pjesmarrje të vetëdijshme si dhe pranimin e të tjerëve të ndryshëm. (Vetë standartizimi i sjelljeve etike në shkollë është detyrë e vështirë për shkak të nënkulturave, grupeve kulturore besimeve individuale etike mjaft të ndryshme).*
- *Aftësinë e prindërve për të kuptuar të miturin, situatën dhe për të mbështetur procesin e integritit të tij/saj.*

Këto objektiva u përpoqëm t'i arrijmë:

- *Duke vendosur si qëllim parësor interesat e të miturit*
- *Duke e dëgjuar e marrë atë seriozisht*
- *Duke mbajtur parasysht moshën dhe nivelin e të kuptuarit*

Results

The project involved approximately 190 children and youth at risk and in conflict with the law, approximately 150 parents, as well as reference institutions, i.e.: courts, probation offices, prosecution offices, police, regional education directorates, 9th grade schools, general and VET schools in Tirana, Durrës, and Puka.

In line, also, with main legal documents such as UN Convention: "Child Protection Manual," the Constitution of the Republic of Albania, all our training sessions (unilateral, bilateral and tripartite programs) our objectives were mainly focused on:

- Enabling minors at risk to be independent, to be able to take the right decisions for them at the right moment and the right place(s),
- The ability to understand oneself and the inherent circumstances;
- The ability to minimize pressure of being integrated, from being "different" towards being oneself, towards being accepted in the right of free choice, while dictating conscious participation, and acceptance of others as different. (The standardization of ethical behavior in and of itself is a difficult task due to sub-cultures, different cultural groups, varied individual ethical beliefs).
- The ability of parents to understand the child, and the situation that he/she is in, and to support him/her in the process of his/her integration.

We tried to achieve these objectives by:

- Placing at the forefront the interests of the child/minor;
- Listening to them, and taking them seriously;
- Taking into account their age, and level of understanding;

- Duke e informuar dhe përfshirë në të gjitha çështjet dhe vendimet që ndikojnë në jetën e tij,
- Duke shmangur izolimin e tij
- Duke mos injoruar përmasat kriminale të pasojave të keqtrajtimit.
- Duke përfshirë prindin në të gjithë këtë proces duke ndjekur të gjitha hapat sa më sipër

A. Pjesëmarrja dhe gjetje

Pjesëmarrja e fëmijëve dhe të rinjve sipas zonave është dhënë në **tabelën 1**:

Pjesëmarrja gjinore është 56% djem dhe 44% vajza, ndërsa sipas vendodhjeve pjesëmarrja gjinore jepet në **tabelën 2**.

Grafiku në vijim paraqet dhe pjesëmarrjen gjinore ku vihet re se risku i përfshirjes së të miturve në konflikt me ligjin, ose që janë tashmë në konflikt, apo janë të përfshirë në sjellje problematike në shoqëri, është më i lartë në Tiranë dhe Durrës, që lidhet me problemet që shoqërojnë zhvillimin metropolitan të rajoneve dhe përballjen e popullsisë në tërësi dhe të të rinjve në veçanti, me teknologjinë, urbanizimin, migrimin e brendshëm, papunësinë, dhe nevojën për integrim social. Ndryshe nga Tirana dhe Durrësi, rasti i të rinjve në Pukë lidhet me probleme që shoqërojnë mungesën e zhvillimit të rajonit dhe përballjen e popullsisë në tërësi dhe të të rinjve

Zona / Location	Djem / Boys	Vajza / Girls
Puka	17%	9%
Durres	17%	16%
Tirana	22%	19%

Tabela / Table 2

- By informing them, and including them in all issues and decisions that affect their lives;
- Avoiding their isolation;
- Not neglecting the criminal dimension of the aftermath of violence.
- Involving parents throughout the process, while following all of the above steps

A. Participation and findings

Participation of children and youth according to areas provided in **Table 1**:

Participation rates according to gender were: 56% boys and 44% girls, whereas gender participation according to areas is given in **Table 2**.


Zona / Location	Pjesëmarrja e fëmijëve dhe të rinjve / Participation of children and youth
Puka	25%
Durres	33%
Tirana	41%

Tabela / Table 1

në veçanti me izolimin gjeografik, varfërinë, mungesën e zhvillimit social dhe teknologjik etj.

Vihet re që numri i vajzave krahasuar me djemtë është më i ulët në tërësi, por tendenca e përfshirjes së tyre në sjellje konfliktuale dhe problematike apo risku i konfliktit me ligjin është më i lartë në Tiranë dhe Durrës, për të njëjtat arsye si më lart, por duke shtuar dhe elementin e mentalitetit: ndrydhja gjinore në Pukë, ndaj nevojës për pranim në grupe sociale në këto dy zona.

Tabela e mëposhtme paraqet pjesëmarrjen e prindërve në krahasim me pjesëmarrjen e të miturve.



The following graph is a presentation of gender participation rates, which indicates that the risk of the involvement of minors in a conflict with the law or those already in a conflict with the law, or with problematic societal behavior is high in Tirana and Durrës, which is an indication of the problems that accompany metropolitan development of regions and encounter of the population general and youth in particular with technology, urbanization, internal migration, unemployment, and the need for social integration. In difference from Tirana and Durrës, the case of youth from Puka is linked with problems that accompany lack of development of the region and the encounter of the population in general and youth in particular, with geographical isolation, poverty, lack of social and technology development etc.

It is evident that the number of girls compared to that of the boys as an overall is lower, but the tendency of their involvement in conflictual or otherwise problematic behavior or risk of conflict with the law is higher in Tirana and Durrës, for the same reasons as above, but adding here the element of mentality: gender oppression in Puka against the need for acceptance in social groups in these two areas.

The following table is a depiction of the participation of parents vis-a-vis participation of minors.

Approximately 80% of the parents of the minors

Zona / Location	Prindër / Parents	Të mitur / Minors
Puka	17%	25%
Durres	31%	33%
Tirana	30%	41%


Tabela / Table 3

Rreth 80% e prindërve të të miturve morën pjesë në projekt, si mbështetës të fëmijëve, por edhe si përfitues të drejtpërdrejtë të ndërhyrjes (ref. Metodologjia e Ndërhyrjes).

Megjithatë raporti i pjesëmarrjes së prindërve krahasuar me të miturit ndryshon nga zona në zonë, siç paraqitet në **grafikun 2**.

U vu re se pjesëmarrja e prindërve u ndikua nga disa faktorë:

- 1) tendenca e pjesëmarrjes së prindërve ka korelacion pozitiv me tendencën e pjesëmarrjes së vajzave (ndjeshmëri më e lartë e prindërve ndaj sjelljeve problematike të vajzave se sa djemve);
- 2) në zona të vogla, ku njohjet shoqërore janë më të larta, ndjesia e "turp-it shoqëror" të prindërve është më e lartë (rasti Pukë, pjesëmarrje më e ulët);
- 3) në zona me ritme të larta zhvillimi, kohë të kufizuar, bashkëjetesë më mikse të grupeve të ndryshme, konkurrencës për punë etj., (rasti i Tiranës, pjesëmarrje më e ulët), tendenca e shkëputjes së prindërve nga rritja e fëmijëve në aspektin e njohjes së tyre, të të kaluarit kohë cilësore me ta, dhe e limitimit të prindërimit në sigurimin e të mirave materiale dhe aksesit, është shumë më e madhe.




participated in the project, to support their children and as direct beneficiaries from the intervention (ref. Methodology of intervention).

However, the participation rates of parents compared to those of the minors is different from one area to the other, as presented in **graph no. 2**.

The participation of parents was influenced by several factors:

- 1) The trend of the participation of parents has a positive correlation with the participation trend of the girls (higher sensitivity on the part of the parents towards problematic behavior of girls as compared to that of the boys);
- 2) In small areas, where the social relations are more intense, the feeling of the so-called "social shame" of the parents is higher (like the case of Puka where the participation was lower);
- 3) In areas with higher development rates, limited time available, mixed co-existence of different groups, completion at work etc., (the case of Tirana, lower participation rates), the trend for parents distance from the upbringing of the children in terms of getting to know them, spending quality time with their children and limiting parenting to just ensuring material things and access is significantly higher.



B. Tipologjia e rasteve, kategorizimi i mjedisit dhe shkaqeve influencuese

Gjatë trajnimeve, diskutimeve dhe sesioneve të këshillimit, fëmijët dhe të rinjtë, si dhe prindërit shprehën opinionin e tyre mbi faktorët, shkaqet dhe peshën e tyre në situatat e të miturve në risk ose në konflikt me ligjin, si dhe mendimin mbi rolin dhe përgjegjësinë e aktorëve influencues në situata të tilla.

Sipas të dhënave zyrtare veprat penale në të cilat përfshihen më shumë të rinjtë janë:

- X vjedhja
- X drejtimi i automjetit në gjendje të dehur ose pa dëshmi
- X shkatërrim prone
- X prodhim dhe shitja e lëndëve narkotike

Veprat penale dhe sjelljet problematike të të miturve të përfshirë në ndërhyrje ishin kryesisht:

- X Dhuna në familje / shkollë / shoqëri
- X Vjedhja
- X Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike
- X Krimi kibernetik (përndjekja, pengimi, shkelja e konfidencialitetit etj.)

Kategoritë kryesore të aspektit socio-ekonomik influencues u listuan: *Arsimi, gjendja ekonomike, njohja me ligjin dhe përbërja familjare.*

Rrathët sociale kryesorë të aspektit mjedisor influencues u listuan: *Familja, shkolla dhe grupi shoqëror.*

B. Typology of cases, classification of environment and influencing causes

During the training sessions, discussions and counseling, children, youth and their parents expressed their views on the factors, causes, and their weight in the situations of minors at risk or in conflict with the law, and the view about the role and responsibilities of the influencing actors under such circumstances.

According to official data, the following represent some of the criminal offences whereby the youth are likely to get more involved in:

- X stealing
- X driving while drunk, or with no driving license;
- X destruction of property
- X production and sale of drugs

The criminal offences and problematic behavior of minors included in the intervention mainly were:

- X domestic violence/violence at school/society
- X stealing
- X Production and sale of drugs
- X Cybercrimes (stalking, violation of confidentiality, oppression, etc.)

The main categories of the social and economic influential reasons included: *education, financial status, awareness of the law and family composition.*

Main social circles of the environment aspect included: *Family, school and social group.*

FAMILJA / FAMILY		
MJEDISI / ENVIRONMENT	Faktorë/Shkaqe Factors/Causes	Pikëzimi i Ndikimit Effect ranking
MJEDISI / ENVIRONMENT	Dhuna Psikologjike, fizike dhe verbale / Psychological, Physical violence and verbal offense	8.2
	Gjendja Ekonomike / Economic Situation	7.8
	Mosmarrëveshje / Disagreements	2.5

Tabela / Table 4

SHKOLLA / SCHOOL		
MJEDISI / ENVIRONMENT	Faktorë/Shkaqe Factors/Causes	Pikëzimi i Ndikimit Effect ranking
MJEDISI / ENVIRONMENT	Bullizmi / Bullyism	5.9
	Marxhinalizimi, Përrjashtimi social / Marginalizing, Social Exclusion	6.8
	Konfliktet mes nxënësve / Conflicts among peers	4.3
	Konfliktet nxënës - mësues / Conflicts of students with teachers	1.7

Tabela / Table 5

SHOQËRI / SOCIAL GROUPS		
MJEDISI / ENVIRONMENT	Faktorë/Shkaqe Factors/Causes	Pikëzimi i Ndikimit Effect ranking
MJEDISI / ENVIRONMENT	Bullizmi i drejtpërdrejtë dhe në rrjete sociale interneti / Direct Bullyism and in social media networks	2.8
	Kërcënime / Threads	6.5

Tabela / Table 6

C. Perceptimi i të miturve mbi faktorët / shkaqet që nxisin sjelljen deviante

Sipas tyre:

Në mjedisin familjar, ata listuan një sërë faktorësh që nxisin sjelljen problematike të tyre si dhuna psikologjike, fizike dhe verbale e ushtruar nga anëtarët e familjes ndaj tyre, ose ndaj një anëtar tjetër, gjendja ekonomike dhe statusi social i familjes, si dhe mosmarrëveshjet në tërësi. Të pyetur për renditjen e këtyre faktorëve ata dhanë këtë pikëzim (tabela 4):

Në mjedisin e shkollës, ata listuan faktorë si bullizmi, ndjesia e të qenurit të marxhinalizuar, përjashtimi social, konfliktet mes moshatarëve dhe mësuesve, marrëdhëniet me mësuesit për ecurinë në shkollë etj. Të pyetur për renditjen e këtyre faktorëve, ata dhanë këtë pikëzim (tabela 5):

Në mjedisin shoqëror, ata listuan në përgjithësi faktorë si talljet, fyerjet (bullizmi) direkte (individuale dhe në grup) si dhe në rrjetet sociale si facebook, instagram etj., si dhe kërcënimet e ndryshme si një nivel më i agravuar i situatave konfliktuale. Të pyetur për renditjen e këtyre faktorëve, ata dhanë këtë pikëzim (tabela 6):

Raporti Kolemian³: vërtetoi se ndryshimet mes nivelit të të miturve, shpjegohen në pjesën më të madhe prej kushteve familjare dhe pozitës shoqërore, dhe jo prej shkollës dhe edukatorëve.

³ James Samuel Coleman (1926 – 1995) - Barazia e Shanseve të Edukimit, 1966, e njohur si Raporti Kolemian

C. Minors' perception about the factors/causes that lead deviant behavior

According to them:

In the home (family) environment, they listed a number of factors that promote problematic behavior, such as: psychological violence, physical violence and verbal offense by their members of household towards them or some other members of the family, the family social and economic status, and any dispute in general. When asked to rank these factors, the following is what they came up with (Table 4):

In the school environment, among the factors, they listed bullying, the feeling of being marginalized, social exclusion, and conflicts among peers and teachers, relations with the teachers about school progress etc. When asked about ranking these factors, the following is what they came up with (Table 5):

In the social environment, they listed factors such as: insults, bullying, direct insult or in group, and insults in social networks, such as: Facebook, instagram etc., and different types of threats, as a more aggravated level of conflictual situations. When asked about ranking these factors, the following is what they came up with (Table 6):

³ James Samuel Coleman (1926 – 1995) – Equality of Educational Opportunities, 1966, known as “Coleman Report”

D. Perceptimi i prindërve mbi faktorët / shkaqet që nxisin sjelljen deviante

Pavarësisht se si të miturit, ashtu dhe prindërit konkluduan në tre mjediset ku gjenerohen faktorët/shkaqet që nxisin sjelljet deviante, ndryshe nga fëmijët dhe të rinjtë, prindërit nuk ishin në gjendje të bënin një klasifikim sipas mjedisit, por i perceptonin të ndërlidhura. Të pyetur për faktorët sipas tyre, pavarësisht mjedisit dhe renditjes, ata dhanë këtë pikëzim (tabela 7):



D. Parents' perception of the factors/causes that lead to deviant behavior

Even though parents, like their children concur about the three environments, so to speak, that generate deviant behavior, in difference from the children and youth, they were not able to rank them according to the environment, but they saw them as inter-related. When asked about the factors, irrespective of the environment and ranking, the following is what they came up with (Table 7):

SHKOLLA, SHOQËRIA, FAMILJA / SCHOOL, SOCIAL GROUPS, FAMILY		
MJEDISI / ENVIRONMENT	Faktorë/Shkaqe Factors/Causes	Pikëzimi i Ndikimit Effect ranking
MJEDISI / ENVIRONMENT	Mungesa e komunikimit brenda familjes / Lack of communication within family	4.5
	Ndikimi negativ i rrjeteve sociale / Negative effect of social media networks	6.5
	Presioni i moshatarëve / Peer to peer pressure	7.7
	Marxhinalizimi si pasojë e mosintegrimit / Marginalization due to disintegration	3.2
	Shkolla në tërësi: niveli dhe ngarkesa mësimore, mungesa e aftësive pedagogjike të mësuesve / School in general situation: academic level and workload, lack of pedagogical skills of teachers	4.6
	Çështje të adoleshencës / Adolescence Issues	3.6

Tabela / Table 7


E. Krahasimi i perceptimeve të mitur / prindër

Pas marrjes së perceptimeve të tyre mbi mjediset ku gjenerohen disa prej faktorëve apo shkaqeve të sjelljeve konfliktuale që janë risk i përfshirjes në konflikt me ligjin, u krahasuan perceptimet e tyre mbi mjedisin që mund të prodhojë më shumë shkaqe dhe pesha që ato kanë në influencim

Rezultatet tregojnë se


Të miturit rendisin mjedisin shkollor që prodhon më shumë shkaqe (pikëzimi 4.4),

Minors rank the school environment as producing more causes (rank 4.4),



por nga mjedisi familjar gjenerohen shkaqe me peshë më të madhe (pikëzimi 4.6).

But weight of causes generated within family/domestic environment is higher (rank 4.6).




E. Comparing perceptions of minors toward those of the parents

After receiving their feedback about the perceptions where some of the factors or causes of conflictual behavior are generated that become cause for conflictual behavior that represent a risk for involvement in situations of conflict with the law, a comparison of their perception about the environment that might generate more causes and their weight was then conducted.

Results demonstrated that:


Prindërit rendisin mjedisin shoqëror që prodhon më shumë shkaqe (pikëzimi 5),

Parents rank the social environment as producing more causes (rank 5),



Por nga mjedisi i shkollës gjenerohen shkaqe me peshë më të madhe (pikëzimi 4.1).

But weight of causes generated within school environment is higher (ranking 4.1).



Përfundime:

Si të miturit, ashtu dhe prindërit tentojnë të “mbrojnë” / ose kanë perceptim bias për mjedisin e tyre të ngushtë: rrethi shoqëror për të miturit dhe familja për prindërit.

të dy palët janë kritikë ndaj mjedisit të shkollës dhe nga ana tjetër e shohin si mjedis dominant: të miturit shohin më shumë shkaqe që gjenerohen nga mjedisi i shkollës, kurse prindërit mendojnë se pesha e tyre është e madhe.

Situata/steriotipe:

Prindërit justifikojnë sjelljet e fëmijëve të tyre: konfliktet e çdo lloji e përmase e quajnë si “një kalamallëk moshe”, ndaj nga ana e tyre mungon stërvitja e fëmijës se si të përballet me problemin dhe si mund të gjendet një zgjidhje sa më e mirë.

Prindërit e “delegojnë” edukimin e fëmijëve të tyre stafit pedagogjik; rrjedhimisht i konsiderojnë dhe si përgjegjësit kryesorë për sjelljet problematike të fëmijëve të tyre.

Fëmijët kanë nevojë për të dominuar mbi konfliktin, dhe nuk mendojnë për pasojat.

Stafi pedagogjik shpesh mohon ekzistencën e problemit

Conclusions:

Both the minors, and their parents try to “protect”/ or have a bias perception about their immediate/close environment: the social network for the minors and the family for the parents.

Both parties are critical about the school environment while on the other hand they perceive it as a dominant environment: minors perceive more causes to be generated in the school environment, whereas parents believe that their weight is bigger.

Situations/stereotypes:

Parents justify the behavior of their children: conflicts of any size or type fall under “it’s an age thing” sort of slogan, so they do not “train” their children in facing the problem, and finding the best possible solution under the circumstances.

Parents “delegate” their children’s education to the teaching staff; consequently, they consider them as the main responsible parties for the problematic behavior of their children.

Children need to master the conflict, but they do not think about the consequences.

The teaching staff often denies the existence of a problem.



Disa reflektime Some reflections

Disa reflektime

Edukimi i të miturve në kontakt apo në konflikt me ligjin kërkon një proces të vazhdueshëm dhe të ndërthur, që çon në një sjellje të përmirësuar. Trajtimi shtesë dhe rezultate më të përshpejtuara, më të thella dhe më të qëndrueshme. Për këtë arsye, sugjerohet që gjatë ndërhyrjeve për trajtimin e të miturve në risk/konflikt me ligjin, përveç trajnimeve përkatëse, trajtimi të përfshijë:

- aspektin e ndërtimit të marrëdhënieve në familje, si faktorë të mjedisit të brendshëm të të miturit,
- aspektin e ndërtimit të marrëdhënies prind – të mitur, si faktor mbështetës dhe kontributor në qëndrueshmërinë e qëndrimit të ri konform ligjit,
- aspektin e krijimit të efektit amplifikues në mjedisin e jashtëm të të miturit, nëpërmjet angazhimit dypalësh prind-të mitur në aktivitete sociale/komunitare/ndërgjegjësuese.

Some reflections

Education of minors in contact or in conflict with the law requires a continuous and mix process which would eventually lead to improved behavior. The additional treatment gave accelerated, deeper and more sustainable results. For this reason, a suggestion would be that during interventions involving minors at risk / in conflict with the law, the treatment should include:

- Aspects of building relations at home, as internal factors of the minors' environment;
- Aspects of building the relationship between minors and parents, as support factors and contributing to the sustainability of the new approach of being in conformity with the law;
- Aspect of creating an amplifying effect in the minors' external environment through bilateral commitment of the parents and the minors in social, community and awareness raising activities.

Përmbledhje e gjetjeve

- Pjesa dërrmuese e rasteve në kontakt apo në konflikt me ligjin, kanë një bazë faktorësh ndikues negativë, të mjedisit të brendshëm dhe të jashtëm (të afërm abuzivë, shoqëri abuzive, përjashtim social) si dhe paraqesin efekt ndikues të tjerët (negativ) (të afërm të abuzuar, shoqëri të abuzuar, ose në kontrast: izolim social) duke dhënë efektin domino. Të rralla shfaqen rastet që burojnë vetëm nga personaliteti i të miturit.
- Kuptueshmëria e ndodhjes në një situatë në kontakt / konflikt me ligjin dhe e faktorëve ndikues nuk është e njëjtë midis të miturve, prindërve, mësuesve, rrethit shoqëror.
- Tendenca për të gjetur “fajin”, shkakun, faktorin të tjerët, dominon si te të miturit, ashtu dhe te prindërit, mësuesit etj.
- Të pyetur për të përcaktuar rëndësinë e tre kategorive kryesore (familja, shoqëria, shkolla), prindërit listojnë shkollën dhe shoqërinë si kontributorë të situatave konfliktuale, kurse të miturit listojnë familjen dhe shkollën (prindërit tentojnë të mbajnë diskret situatën familjare, kurse të miturit tentojnë të mbrojnë rrethin shoqëror)
- Vihet re numër i konsiderueshëm i përfshirjes së vajzave në situata konfliktuale shoqërore dhe familjare, në kontakt dhe konflikt me ligjin.
- Rastet e të miturve në projekt kanë treguar se të gjithë anëtarët e familjeve përkatëse janë të ndikuar negativisht, pavarësisht nivelit të ndryshëm të ndikimit.

Summary of findings

- The majority of the cases in contact or conflict with the law have at their core a number of negative factors of the internal and external environment (abusive relatives, abusive society, social exclusion) and have a negative impact/influence on others (relatives that have been victims of abuse, society that has been abused with or in contrast: social isolation) which lead to a domino effect. Very few cases are related only with the personality of the minor.
- Understating of why a situation of contact/conflict with the law is happening, and why that is not the same among minors, parents, teachers and the social network.
- The tendency of finding “guilt”, cause and factors with the others prevails among the minors, parents and teachers alike, etc.
- When parents were asked to provide in order of importance for these three main categories (family, society and school), they rate the school and the society as the main contributors behind conflictual situations, whereas minors list the family and the school (parents try to be discreet about their family circumstances, while minors try to protect their friends)
- There is a considerable number of girls involved in social and family conflicts situations in contact and conflict with the law.
- Cases of minors involved in the project demonstrate that all members of the respective family are adversely impacted, irrespective of the level of impact.

Rezultatet e sesioneve të trajnimeve Results of training sessions

- Njohja dhe informimi mbi kuadrin ligjor u mirëprit nga të gjithë prindër, të mitur. Angazhimi i tyre u realizua, si dhe motivimi dhe dakortësia për të qënë konform me ligjin ishte i plotë.
- Angazhimi i institucioneve edukuese, ligjvënëse dhe ligjzbatuese ishte i plotë. U arrit të vendoset njohje dhe komunikim mes gjithë palëve të përfshirë (prindër, të mitur, institucione edukuese, ligjvënëse dh ligjzbatuese).
- Të pyetur përpara dhe pas sesioneve, niveli i pohimit të qëndrimeve konform ligjit për shkak njohjes dhe angazhimit në situata (win – win) nga projekti, është pozitiv.

- Awareness and information about the legal framework was welcome by parents and minors alike. They were involved and agree on the importance of being on the side of the law, and acting in conformity with it.
- The education, law enforcing and law making institutions were fully involved. The initiative managed to establish communication links and ensure connection among all parties (parents, minors, education, law enforcement and law making institutions).
- When asked before and after the sessions, the level of acceptance of attitudes on the side of the law/in line with the law as a result of information and indolent in win – win situations of the project is positive.

Puna më tej me raste të veçanta

Pavarësisht pohimit pozitiv të qëndrimit konform me ligjin, ndryshimi i sjelljes është një proces i gjatë, i vështirë dhe përfshin shumë faktorë dhe aktorë, sidomos brenda familjes (dispozicioni për ta ekspozuar është më i ulët). Shpeshherë, pavarësisht dëshirës për të ndryshuar pozitivisht, ndikimi i faktorëve të mjedisit të brendshëm dhe të jashtëm (si ushtrimi i dhunës/neglizhencës psikologjike, fizike, verbale, ekonomike etj.), stopon procesin e ndryshimit pozitiv të sjelljes dhe madje rrisin të rikthejë agresivitetin, apo të rrisë nivelin e kontaktit dhe konfliktit me ligjin të të miturit.

Further work with specific cases

Despite positive efforts of acceptance for being in line with law, behavior change is a lengthy, difficult process with the involvement of many actors and factors, in particular within the family (the predisposition to expose it is lower). Often times, irrespective of the wish for a positive change, the influence of external and internal environment factors (such as: exercise of violence/psychological, physical, verbal and economic neglect etc.) tends to stop the process of positive behavior change, and risks to bring back aggressiveness or further enhance the levels of contact or conflict with the law of the minors.

Ky fokus i kontributit në ndërtimin e sjelljes me bazë familjen, u aplikua në disa prej rasteve të identifikuar. (ref. Metodologjia e Ndërhyrjes).

Avantazhet e metodologjisë së aplikuar:

- Rastet e trajtuara shfaqën qëndrime të reja, në të mirën e tyre dhe konform me normat shoqërore dhe ligjin.
- Qëndrimet e reja janë konstante. Nuk janë vënë re luhajtje të sjelljes së ndryshuar, që ul riskun përsëritjes së kontaktit/konfliktit me ligjin.
- Qëndrimet e reja paraqesin nivel qëndrueshmërie më të lartë në rastin e të miturve të trajtuar me prindërit sipas metodologjisë shtesë. Ata janë të përfshirë në modele pozitiviteti dhe në angazhim për të avancuar në jetë, jo thjesht për të qënë konform ligjit.
- Prirja e mbështetjes së anëtarit nga anëtarët në familje është më e lartë.
- Prirja që i mituri me qëndrimin e ri dhe me ndihmën e prindit të transmetojë model brenda familjes është më i lartë, si dhe ka shanse që të jetë këshillues dhe parandalues për konfliktet e anëtarëve të tjerë brenda dhe jashtë familjes.
- Modelet tradicionale të perceptimit të rolit gjinor dhe asocimit të disiplinës me dënimin janë zbehur në rastet e trajtimit shtesë.

This focus of contributing in building a family-based behavior was applied in several of the identified cases. (Ref: Intervention Methodology).

Advantages of applied methodology:

- Cases that were part of the project displayed new attitude, to their benefit, in conformity with social norms and the law.
- New attitudes are constant. There have been no behavior fluctuations observed, which reduces risk of repeat situations of contact/conflict with the law.
- New attitudes represent higher levels of sustainability in the case of minors who came together with their parents, according to the additional methodology. They were involved in positivity models, and displayed commitment to move forward in life, and not merely be in conformity with the law.
- The inclination of supporting a family member by the members of the same household is higher.
- The trend that a minor that has endorsed a new attitude, and with the support of the parent should convey a role model within the family is higher, while there is a good measure of chance for the minor to act as an advisor and prevent conflicts among other members of the household and outside.
- Traditional models of perceptions of gender role models and association of discipline with punishment have lost ground in the additional training cases.



**Mesazhe nga të miturit
në risk/konflikt me ligjin dhe prindërit e tyre**

**Messages from the minors at risk/in conflict
with the law, and their parents**

Mesazhe nga të miturit në risk / konflikt me ligjin dhe prindërit e tyre

A.C 14 vjeçe jeton me mamanë, motrën dhe vëllain. I ati është konsumues i alkoolit, gjë që përbën edhe një ndër shkaqet kryesore të dhunës në familje. Gjithashtu familja ndodhet në kushte shumë të vështira ekonomike (prindërit e papunë, shtëpi me qera). Babai nuk është i pranishëm në kujdesin ndaj shtëpisë dhe familjes. A.C me të ëmën i janë drejtuar disa herë komisariateve të policisë për të kërkuar ndihmë, por asnjëherë urdhër mbrojtjeje.

“Babi im nuk duket fare në shtëpi, ai edhe kur vjen ndonjëherë, rref mamin e ikën prapë. Problemi im tani është me mamin, e cila është bërë tamam si ai. Më gjuan, më shkul flokët, më bërtet, më kontrollon për çdo gjë, as në shkollë nuk më le të iki. Për gjënë më të vogël më gërthet dhe më gjuan. Jam gjithë nerva dhe e mërzhitur. Mamit tani as i them asnjë gjë se s’ja vlen. Vetëm me motrën flas,me thënë të drejtën, shajmë mamin se na e ka sjellë majë hundës.” - AC

“Po çfarë të bëj? E rrah ndonjëherë gocën, se s’merr vesh ndryshe. Edhe ajo ka filluar të më kthejë fjalë. Ku marrin vesh këta fëmijët e sotëm. Kot s’ka thënë populli “Druri ka dalë nga xheneti”. “Burri? Ca të them e zeza për të! Na shkatërroi. Mua më ka fut në dhe nga turpi. Më hall kam këtë gocë. Shpirti ma di që kaq e vogël dhe filloi dyerve të policisë. S’dua të më turpërojë, as të

Messages from the minors at risk/in conflict with the law, and their parents

A.C is a 14 years old girl who lives with her mother, sister and brother. Her father is an alcoholic, and that is one of the leading causes of domestic violence. The family is suffering financially as well (the parents are unemployed; they live in a rented home). The father is absent and does not have a care about the home and family. A.C and her mother have gone several times to the police station, to seek help, but they have never been issued a protection order.

“My father does not show up at home almost never, but even when he does come home, he beats up my mother, and then leaves again. My mother is now my problem because she is turning into him. She beats me, she tears my hair, she screams at me, and checks everything I do. She will not let me go to school. I am very tense and upset. I don’t tell my mom anything anymore. It simply is not worth it. I only talk to my sister...about our mom. We have had it up to nose with her.” - AC

“What do you expect me to do? I beat my daughter sometimes. She won’t listen otherwise. She retorts to what I say. Children nowadays are not the same. They do not listen. The old saying about beating them is not in vain “The stick derives from paradise”. “My husband? What the hell do you want me to say about him! He ruined us all. I am too ashamed to be walking outside. I am more worried

ngatërrohet me ndonjë djalë të keq, as të thonë komshinjtë “goca e filanit.” – Nëna e A.C

Si pjesë e programit UNICEF, trajtimi i sesioneve prind-fëmijë u përqendrua në rregullimin e marrëdhënieve të tyre, në ndryshimin e perceptimit që ato kanë ndaj njëra-tjetrës, nga skemat sulm-mbrojtje në skemat mbështetese, për të përballuar situatat, si dhe për të qënë pozitive dhe ndaj dy pjesëtarëve të tjerë të familjes.

“S’kam patur ndonjë sherr. Mami është bërë mirë, si bosa i them, se vjen e hyn në muhabete me mua dhe motrën, e bëhemi të treja si grup. E ka liru pak kontrollin, vazhdon thotë kujdes këtu, kujdes me filanin etj., po i thotë tani si më qetë. Në shkollë shkoj. Do kisha qejf të bëja ndonjë gjë gjatë verës, që mos të rrija në shtëpi.” A.C

“Oyqa, me këto që mësova, për zotin, paskam qenë më keq se burri. Më raftë pika që e kam rraf gocën, kot më si kot. Tashi dhe ajo duhet me ul içik nervat e të sillet më mirë, po për zotin tani vetëm i kam gërthit ndonjëherë, por për ta rraf, jo. Ajo që na thatë me bo një gjë bashkë se na bën mirë? Morëm qëndisëm bashkë kryq një rruçicë thesi. Unë nga njëra anë, goca nga ana tjetër. Të betohem, qëndisnim dhe tregonim qyfyre. Për marshallah, thashë me vete. Rrofshit ju.” - Nëna e A.C

about my daughter. I am devastated that at such tender age she has to knock on the doors of the police stations. I do not want her to shame me, or to get involved with a bad boy, so that our neighbors start spreading gossip about us.” – The mother of A.C

As part of the UNICEF program, the parent-children sessions focused on improving the relations between them, in changing the perception about each-other, and moving from attack-defense schemes into support schemes, in order to face any situation, as it arises, and to be positive towards other members of the household.

“I have not been involved in any quarrels. My mom is becoming cool, and she is now talking to me and my sister, and we are now a team. She is less controlling, but continues to tell me to be careful, in a better mood. I now go to school. I would have liked to be busy during summer, so that I would not stay at home.” A.C

“What I learned opened my eyes! I must have been worse than my husband. I should be dammed for beating my daughter in vain. Ok, she also needs to calm down a bit, and behave, but now I swear I have talked loudly to her sometimes, but I would never lay a hand on her. Remember you told us that we should spend time together! You know what we did? We started sewing. Both of us, I started from one end, she from the other. I swear we were sewing, and laughing. Marshallah, I used to say. May God bless you.” - Mother of A.C

A.F 17 vjeç vjen nga një famije e komunitetit rom, me dënim alternativ për vjedhje. Ai jeton së bashku me prindërit dhe vëllezërit e martuar me fëmijët e tyre, në të njëjtën banesë. A.F nuk e ka përfunduar arsimin nëntëvjeçar, kurse i ati, punon duke mbledhur kanaçe dhe hekurishte.

"Ishte e rond kur m'ka kap policia e m'futën n'burg. Me thën t'drejtën kisha içik frik. T'gjith cunat e kan provu ka iher burgun. Hera e par që m'kapën se unë kam pi dhe hashash, por kam shpëtu." - A.F

"M'ka ardh shumë keq kur e arrestun çunin, se nuk dija ku të përplasja kokën dhe nuk kisha as lek. E di që im bir ka bo gabim dhe un s'e kam kontrollu... por s'kam ca t'boj. Gjith ditën rri duke mbledh kanoçe mes diellit e mes ftohtit. Vij në shpi e jam l lodh. Di unë ç'bën ky rrugve. Edhe shkollën e la." - Babai i A.F

Trajtimi i dyshes prind – fëmijë në rastin e tyre u fokusua në ndërtimin e marrëdhënies baba-bir për gjetjen e mënyrave në zgjidhjen e konflikteve, duke qënë se jetojnë dhe me shumë pjestarë në familje.

Si i mitur në konflikt me ligjin dhe në vuajtje të dënimit alternativ për vjedhje, trajtimi i A.F është fokusuar më tej, në gjetjen e mënyrave për t'u riintegruar, specifikisht duke e nxitur të punojë dhe duke i listuar të mirat, jo vetëm ekonomike por dhe në shoqëri.

"Jam sjell mirë, i rri larg ngatarresave. Me thon t'drejtën, shoh nonji gjo që s'm'pëlqen, largohem se s'du t'ngatarrohem kot. Po punoj me plakun me kanocet. Ishalla filloj nonji pun si mekanik makinash se i kom qef shumë e ju do mnimoni se per shkoll sja them." - A.F

A.F is a 17 years old boy who comes from a Roma community family, suffering alternative punishment for stealing. He lives together with his parents and his married brothers together with their families in the same space. A.F has not completed 9th grade education, while his father gathers scrap for recycling.

"I felt bad when the police caught me. To tell the truth, I got a bit scared. All boys have been to jail at least once. It is the first time they get me. I used to smoke hash, but managed to get away with it." - A.F

"I was so sad when they arrested my boy, because I did not know what to do, and who to turn to. I know my son is in the wrong and I did not take care of him, but what can I do. I gather bins under the heat and in the midst of the cold. When I come home, I am too tired. I do not know what he does all day. He quit school as well." - the father of A.F

The suspicious parent – child treatment, in their case focused on building a father son relationship, in finding ways for solving conflicts, given that this an extended family.

As a minor in conflict with the law, and suffering alternative punishment for theft, treatment of A.F further focused on ways for re-integration, specifically urging him to find a job, and making a list of benefits, not just economic, but also for the society.

"I have been behaving. I stay away from trouble. When I see something I dunno like, I move away because I do not want to get in trouble. I help my old man collect bins for recycling. I hope I can work as car repair man, 'cause I really like 'em. You'll help me cause school aint my thing." - A.F

Xh.H 15 vjeç është në klasën e nëntë dhe ka rezultate shumë të ulëta në mësim. Ai ka pasur probleme të herëpashershme me policinë, herën e parë është konfliktuar verbalisht dhe fizikisht me një shokun e tij dhe e ka kërcënuar me armë. Më pas, sërish është kapur nga policia për shpërndarje dhe përdorim të lëndëve narkotike dhe është mbajtur disa ditë në paraburgim.

Familja e tij përbëhet nga gjashtë anëtarë, me të ardhurat e familjes janë tepër të ulëta, sepse babai punon (sezonalisht) në ndërtim. Vajzat e familjes nuk e kanë vazhduar dot ciklin e mesëm të shkollës, për shkak të vështirësive ekonomike.

“Kam qenë shumë herë në rajon policie dhe më pas kam dalë. S’dua të sillem keq, por ja që detyrohem ndonjëherë. Më vjen keq që i mërzis prindërit, sidomos babin” – Xh.H.

“Më vjen shumë keq për vajzat që i lashë pa shkollë, por nuk kisha mundësi. Këtij të voglit, që ia kam plotësuar të gjitha, ky po më mundon më shumë. Më nxjerr nga bina-rët.” Babai i XH.H

“Ky djalë nuk bëhet... do mbesi burgjeve” – të tjerë

U konstatua që i mituri vuante nga përjashtimi social dhe dhuna verbale dhe psikologjike, por sidomos nga i ati që e konsideronte si dështim personal, por i mituri në vet-vete kërkonte vlerësimin e të atit. Trajtimi i dyshes prind – fëmijë në rastin e tyre u fokusua në gjetjen e një linje të përbashkët komunikimi, me vetëvlerësimin si dhe me rrethin e njohjes.

Xh.H dhe babai janë pjesë e prindër-të miturve që punojnë për të bindur të tjerë të mitur në kontakt apo në konflikt

Xh.H is 15 years old and is in the 9th grade, performing very badly in school. He has had frequent problems with the police, and for the first time he had a verbal and physical conflict with a friend, who he threatened with a gun. Then, the police apprehended him for distribution and use of narcotics and was kept in pre-detention for several days.

His family has six members, and the family income is really low. His father does seasonal construction work. The girls of the family could not pursue secondary education because of financial problems.

“I have been apprehended by the police several times, and then they let me go. I do not want to misbehave, but sometime I have to. I am sorry I upset my parents, in particular my dad” – Xh.H.

“I am very sorry about my girls who cannot go to school, but I could not afford it. This one, is the youngest. I have tried to give him everything he asks for, but he is the one who is giving me the worst headache. He is making me going crazy.” The father of XH.H

“This boy is good for nothing” – according to others.

We observed that the minor was suffering from social exclusion, and verbal and psychological violence, in particular by the father, who considered him as a personal failure, while the minor was looking for his father’s appreciation. The suspicious treatment between the father and the son, in their case, focused on finding a common line of communication, through the process of self-esteem and the recognition circle.

me ligjin dhe prindërit e tyre, për të pranuar ndihmën nga projekti. XH.H është tashmë dhe vullnetar pranë “Sot për të Ardhmen”, për të ndihmuar fëmijët gjatë kampit veror.

“Vërtet mendoni se unë mund të ndihmoj dhe prindër të tjerë? Po jam gati.” – Babai i XH.H

Xh.H and his father are part of the parents-minors group who work for convincing other minors in contact or conflict with the law, and their parents, to accept the help of the project. XH.H is one of the volunteers of “Sot për të Ardhmen”, and helps the children in the summer camp.

“You really think I can help other parents? If so, I stand more than ready.” – the father of XH.



A.B 17 vjeçe, është në shkollë të mesme profesionale. I ati punon me kohë të pjeshme në ndërtime dhe familja ndodhet në kushte të vështira ekonomike. A.B shfaq sjellje rebeluese dhe konfliktuozë me shoqërinë e saj dhe në shkollë. Ajo ka marrë disa herë masa paralajmëruese për përjashtim nga shkolla, për shkak të frekuentimit jo të rregullt dhe sjelljeve të dhunshme në mjediset e shkollës ndaj bashkëmohatarëve dhe mësuesve. Në këtë rast policia është mjaftuar me vërejtje dhe është lënë në gjendje të lirë.

“Unë kam shkuar disa herë në polici, por nuk është faj i im. Mua më ngacmojnë shoqet dhe unë i toleroj derisa nuk mban më durimi im. Nuk jam krenare për këtë gjë, por të tjerët e dinë çfarë tipi jam dhe më ngacmojnë kastile...” – A.B

“Të ëmën nuk e llogarit fare. Mua më dëgjon disi më shumë. E kemi si çun.” – babai i A.B.

“Po erdhi plakun në takim, unë do iki. Po të jemi vetëm çuna, goca flas. Përndryshe e qep gojën” – A.B

“S’ka problem. Po qe se nuk do të jem, më mirë veç” – babai i A.B

Gjatë programit UNICEF, u konstatua se prindi në këtë rast ishte “pasues”, ndaj fillimisht u punua me të miturën në drejtimin e energjive të saj. A.B e projektonte potencialin e saj për të “drejtuar” në trajtën e konfliktit pasi në ambientin shoqëror ndihej inferiore për shkak të varfërisë. Pas trajtimit individual mbi perceptimin dhe kuptimin e dashurisë dhe cilësive prindërore, pavarësisht mundësive ekonomike, trajtimi prind – fëmijë u bë i mundur. Nuk ka raportim nga shkolla për përfshirje të të miturës në sjellje të dhunshme apo armiqësore ndaj të tjerëve.

“E kam rob të mirë, plakun. I kam rënë ca në qafë. Është pak më i urtë seç duhet, po nuk më fëlliq” – A.B

“Po sikur është urtësuar goxha!” – babai i A.B .

A.B is a 17 years old girl who goes to a vocational education training school. Her father does part time construction work, and her family’s financial situation is difficult. A.B displays conflictual behavior at school, and with her peers. She has received several warnings from school, to be expelled, because of absences and violent behavior in the school premises and against her peers and the teachers. In her case, the police has just scolded her, and set her free.

“I have been at the police several times, but it is not my fault. My friends tease me, and I put up them until I cannot do it anymore. I am not proud of this, but they know me, and they do it on purpose to get on my nerves...” – A.B

“She pays no attention at all to her mother. She gets better on with me. She is like a tomboy.” – The father of A.B.

“If my old man comes to the meeting, I leave. If it’s only girls and boys, I can talk. Otherwise, I will keep my mouth shut” – A.B

“It is ok. If she does not want me to be there, I will not be there. Better that way” – the father of A.B

During the program of UNICEF, we noted that the parent was more of a “follower”, so in the beginning we worked with the minor, in trying to channel her energies. We discovered that A.B was trying to “lead” because she felt inferior because of her poverty. Following individual treatment about the perception and meaning of love and parental qualities, irrespective of financial possibilities, the parent-child relationship was made possible. The school has not reported about the minor’s involvement in violent or hostile behavior against others.

“My old man is a good fella. I have been mean with him. He is a bit slow, but I do not feel embarrassed by him” – A.B

“She seems quite changed! ” –the father of A.B .

K.A dhe K.M janë kapur teksa shpërndanin lëndë narkotike dhe janë dënua nga gjykata e shkallës së parë me 40 ditë heqje lirie, dëmin të cilin e kanë kryer me burgim dhe janë me detyrim paraqitje pranë institucionit të Shërbimit të Provës. K.A është fëmijë konfliktual në familje dhe në shoqëri, kurse K.M është konfliktual, përdorues i rregullt i lëndëve narkotike si dhe shpërndarës. Marrëdhëniet e tyre janë K.M lider dhe K.A pasues. Nëna e K.M shfaq distancim nga i biri për shkak të turpmit shoqëror, kurse K.A përbuz të atin për shkak të varfërisë.

“Nuk kam ca them.” – K.A.

“Ca të them. Iku, u bë.” K.M

“Aman, ndihmojeni të bëhet njeri! Vëreni në punë, këtu në qendër, të edukohet, të rrijë me njerëz të mirë, t’i kthehet shkollës. Unë jam në pension, nuk e ndihmoj dot.” – babai i K.A

“Ju lutem, mund të mos vi unë në takim? Më vjen shumë zor” – nëna e K.M

Në programin e UNICEF, të dy rastet dhe me udhëzim nga Shërbimi i Provës u trajtuan me skemën: prind-fëmijë (veçmas), si dhe marrëdhënia mes dy shokëve. K.A ka vendosur të përsërisë vitin e tretë të shkollës së mesme dhe synon të diplomohet. K.M ndihmon në aktivitetet me të moshuarit. Ai po zhvillon talentin e tij në ideim faqe interneti për turizmin dhe po punon me “Sot për të Ardhmen” për të nisur kursin e guidave malore. Shërbimi i provës ka konstatuar që të dy janë më socialë me njerëzit.

“Janë mburrur shokët kur kanë qënë shoqëruar në komisariat, por burgun ishte ndryshe. Do bëja çdo gjë për mos u kthyer atje. Shkollë, punë...çdo gjë.” – K.A

“Më pëlqen më shumë puna që bën qendra me të moshuarit dhe interneti.” – K.M

K.A and K.M were caught distributing drugs, and have been sentenced by the first instance court with 40 days of prison, and the obligation to present themselves to the Probation Office. K.A is a conflictual child at home and with his peers, while K.M is conflictual and regular user of drugs, and distributor as well. K.M is the “leader” and K.A is his “follower”. The mother of K.M feels social shame on account of her son, while K.A is disgusted by his father because he is poor.

“I do not know what to say.” – K.A.

“What can I say? Let bygones, by bygones.” K.M

“Please, try to help him become a human being! Make him work, train him to stay with good people, and make him go back to school. I am retired and I cannot help him” – the father of K.A

“Please, I do not want to be in the meeting. I am too embarrassed” – the mother of K.M

In the UNICEF program, both cases, with the instruction as well of the Probation Service were addressed through the following schemes: parents-children (separately), and the relations among peers. K.A decided to repeat his third year of second education, and aims to get a diploma. K.M helps in the activities with the elderly. He is working on his skills as webpage designer for tourism, and is working with “Sot për të Ardhmen”, to start the course on mountainous guides. The probation services noted that both are more social.

“My friends were boasting about being taken to the police station, but to actually go to jail is different. I would do anything it takes not to go back. School, a job...anything.” – K.A

“I love the work with the elderly and the internet.” – K.M

Rrjeti “Sot për të Ardhmen”

“Sot për të Ardhmen” është rrjet lider në Shqipëri për mobilizim dhe fuqizim të komuniteteve në nevojë.

Udhëhequr nga vizioni dhe duke përdorur metoda inovative dhe gjithëpërfshirëse, “Sot për të Ardhmen” ka krijuar përjasje të suksesshme të fuqizimit gjinor; vullnetarizmit; aktivizmit; mbrojtjes së mjedisit; ndërmjetësimit për punësim; shërbimeve, përfshirjes dhe mobilizimit komunitar, ushtrimit të së drejtës qytetare, respektimit të ligjit, në mirëqeverisje dhe bashkëpunim institucional.



Zyra Koordinuese Tiranë:

Adresa: Rr. Elbasanit, P. Abau, H2,K6, AP 13, Tiranë

Tel & Fax: +355 4 230 24 10

Qendra Komunitare Durrës:

Adresa: Rr. Leon Tolstoi, Lagja 17, skolina 5, Ish-Kenete, Durres

Tel: +355 5 290 10 70

Qendra Komunitare Pukë:

Adresa: Sheshi Tërbuni, Sh5, pranë Bashkisë Pukë, Pukë

Tel: +355 2 122 29 19



CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Qendra për zhvillim komunitar “Sot për të ardhmen”

Integrimi dhe ri-integrimi i të miturve në shoqëri / Qendra

për zhvillim komunitar “Sot për të ardhmen” ; përkth.

Evis Cerga. – Tiranë : Sot për të ardhmen, 2016

36 f. : me foto ; 24 x 19 cm.

ISBN 978-9928-4302-2-9

1. Të rinj
2. Puna me individë dhe familje me probleme sociale
3. Projekte të zhvillimit
4. Shqipëri

364.4 -053.6(496.5) (083.94)

“Today for the Future” Network

“Today for the Future” is a leading network in Albania for mobilization and empowerment of communities in need.

Driven by the vision as well as using innovative methods, “Today for the Future” has scored successful approaches of gender empowerment, volunteering, activism, environment protection, employment mediation, services, community participation and inclusion, exercision of civic rights, rule of law, good governance and institutional cooperation.



Tirana Coordination Office:

Address: Rr. Elbasanit, P. Abau, H2,K6, AP 13, Tirana

Tel & Fax: +355 4 230 24 10

Durres Community Center:

Address: Rr. Leon Tolstoi, Lagja 17, skolina 5, Ish-Kenete, Durres

Tel: +355 5 290 10 70

Puka Community Center:

Address: Sheshi Tërbuni, Sh5, pranë Bashkisë Pukë, Puka

Tel: +355 2 122 29 197



Tirana National Library Cataloging-In-Data

Community Development Center “Today for the Future”

Integration and re-integration of miors in society / Community

Development Center “Today for the Future” ; transl.

Evis Cerga. – Tirana : Today for the Future, 2016

36 p. : with photos ; 24 x 19 cm.

ISBN 978-9928-4302-2-9

1. Youth
2. Work with individuals and families with social problems
3. Development projects
4. Albania

364.4 -053.6(496.5) (083.94)




Rrjeti për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhen”

 info@cdc-tff.org

 www.facebook.com/AlbanianCommunityCentre

 www.youtube.com/SotPerTeArdhmen

 www.twitter.com/SotPerTeArdhmen

 www.cdc-tff.org



unicef 

ISBN: 978-9928-4302-2-9



9 789928 430229